

DEKLARATË E TË DREJTAVE TË FËMIJËS (20 nëntor 1959)

Hyrje

Duke pasur parasysh që, në Statut, popujt e Kombeve të Bashkuara kanë ripohuar besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut dhe në dinjitetin dhe vlerat e tij, dhe janë deklaruar të vendosur të favorizojnë progresin social dhe të vendosin kushte më të mira jetese në një liri më të madhe;

Duke pasur parasysh që, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që, të gjithë mund të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë që u janë parashtruar pa dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinionin politik ose të çdo lloji tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, kushtesh ekonomike ose të lindura, dhe çdo lloj gjendjeje tjetër;

Duke pasur parasysh që fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale, ka nevojë për mbrojtje dhe kujdesje të veçantë përfshirë këtu dhe një mbrojtje juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe mbas lindjes;

Duke pasur parasysh që nevoja e kësaj mbrojtjeje të veçantë është parashtruar në Deklaratën e 1924 mbi të drejtat e fëmijës dhe është njohur si në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut ashtu dhe në statute të veçanta të Organizatave ndërkombëtare që i kushtohen mirëqënies së fëmijëve;

Duke pasur parasysh që njerëzimi ka për detyrë t'i përkushtohet fëmijës më së miri.

Asamblea e Përgjithshme

Shpall këtë Deklaratë të të Drejtave të Fëmijës me qëllim që ai të ketë një fëmijëri të lumtur dhe të gëzojë, në interes të fëmijës dhe të gjithë shoqërisë, të drejta dhe liri që i janë parashtruar; fton prindërit, burrat dhe gratë si persona të veçantë, ashtu si dhe organizatat joqeveritare, autoritetet lokale dhe qeveritë e shteteve të njohin këto të drejta dhe të bëjnë të mundur respektimin e tyre anë të masave ligjore dhe mënyrave të tjera të adoptuara gradualisht në zbatim të parimeve të mëposhtëme.

Parim i parë: fëmija duhet të gëzojë të gjitha të drejtat e parashtruara në këtë Deklaratë. Këto të drejta duhet t'u njihen të gjithë fëmijëve pa asnjë lloj përjashtimi, pa dallim dhe diskriminim të bazuar mbi racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, fenë, opinionin politik, origjinën kombëtare ose shoqërore, kushtet ekonomike, kushtet e lindura, ose çdo lloj gjendjeje tjetër, si në rastin kur kjo i përket fëmijës ashtu dhe kur i përket familjes së tij.

Parim i dytë: fëmija duhet të ketë një mbrojtje të veçantë dhe të gëzojë mundësi dhe lehtësi, në bazë të ligjit dhe masave të tjera, që të jetë në gjëndje të rritet në mënyrë të shëndetshme dhe normale nga ana fizike, intelektuale, morale, shpirtërore dhe shoqërore, në kushte lirie dhe dinjiteti. Në adoptimin e ligjeve që shërbejnë për këtë synim, gjëja kryesore që duhet të merret parasysh është interesi superior i fëmijës.

Parim i tretë: fëmija qysh nga lindja ka të drejtën e një emri dhe një kombësie.

Parim i katërt: fëmija duhet të ketë sigurimet shoqërore. Duhet të ketë mundësi të rritet dhe të zhvillohet në mënyrë të shëndetshme. Me këtë qëllim duhet t'i sigurohen, atij dhe nënës së tij kurat mjekësore dhe një mbrojtje sociale e përshtatshme, në mënyrë të veçantë në periudhën para dhe mbas lindjes. Fëmija ka të drejtë të ushqehet, të strehohet, të argëtohet dhe të kurohet në mënyrë të përshtatshme.

Parim i pestë: fëmija i vonshëm ose jonormal përse i përket gjendjes së tij fizike, mendore ose shoqërore, ka të drejtë të trajtohet, të edukohet dhe të kurohet në mënyrë të veçantë duke i dhënë atij gjithçka ai ka nevojë për gjëndjen dhe kushtet e veçanta në të cilat ai ndodhet.

Parim i gjashtë: fëmija, për një zhvillim sa më të mirë të personalitetit të tij ka nevojë për dashuri dhe ngrohtësi. Ai duhet, përse është e mundur, të rritet nën kujdesin dhe përgjegjësinë e prindërve dhe, sidoqoftë, në një ambient të ngrohtë dhe të sigurtë si nga ana materiale ashtu dhe nga ajo morale. Me përjashtim të rasteve të veçanta, fëmija i vogël nuk duhet të ndahet nga nëna. Shoqëria dhe fuqitë publike, kanë për detyrë të kujdesen në mënyrë të veçantë për fëmijët e ndarë nga familja ose për ata që nuk kanë mundësitë për një zhvillim normal. Është e dëshirueshme, që për familjet me shumë fëmijë të jepet mbështetje nga shteti ose ndihma të tjera për rritjen e fëmijëve.

Parim i shtatë: fëmija ka të drejtën e një edukimi, që të paktën deri në një nivel elementar të jetë falas dhe i detyrueshëm. Ai ka të drejtë të gëzojë, një edukim i cili të ndihmojë kulturën e tij të përgjithshme dhe t'i lejojë, në një gjëndje mundësish të barabarta, të zhvillojë prirjet e tij, gjykimin e tij personal, ndjenjën e përgjegjësisë morale dhe shoqërore dhe të bëhet një pjestar i dobishëm i shoqërisë. Interesi superior për fëmijën duhet të jetë ndjenja që sundon tek ata që kanë përgjegjësinë e edukimit dhe drejtimit të tij; kjo përgjegjësi bie më së pari tek prindërit e tij. Fëmija duhet të ketë të gjitha mundësitë t'u përkushtohet lojrave dhe aktiviteteve krijuese që kanë si synim edukimin e tij; shoqëria dhe fuqitë publike duhet të bëjnë ç'është e mundur për realizimin e kësaj të drejte.

Parim i tetë: në çdo lloj situatë fëmija duhet të jetë një nga të parët që të mbrohet e të ndihmohet.

Parim i nëntë: fëmija duhet të mbrohet nga çdo lloj pakujdesie, dhune ose shfrytëzimi. Ai nuk duhet t'i nënshtrohet asnjë lloj tregëtie. Ai nuk duhet të futet në punë para se të ketë arritur një moshë të përshtatshme. Në asnjë mënyrë nuk duhet të detyrohet ose të autorizohet të futet në një vend pune që dëmton shëndetin ose pengon zhvillimin e tij fizik, mendor ose moral.

Parim i dhjetë: fëmija duhet të mbrohet nga çdo lloj veprimi që mund të çojë në një diskriminim racial, fetar apo çdo lloj diskriminimi tjetër. Duhet të edukohet me një frymë mirëkuptimi, tolerimi, miqësie midis popujve, paqeje dhe vëllazërimit botëror, dhe me ndërgjegjen që duhet të përkushtojë energjitë dhe inteligjencën e tij në shërbim të njerëzimit